

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 224, datë 27.3.2026

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 196, DATË 11.4.2023,
“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR
DREJTUES TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe të pikës 10, të vendimit nr. 424, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së për zgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 196, datë 11.4.2023, “Për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, pas pikës 1 të udhëzimit, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Komisioni, në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, harton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar të cilët janë vlerësuar me mbi 60 (gjashtëdhjetë) pikë të renditur sipas pikëve, dhe ia përcjell atë ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis SALA

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela KUMBARO